



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË



Nr 1382 Prot

Tepelenë, më 15/06/2022

### Njoftim publik

Bazuar ne Programin Social te Strehimit “Për Subvencionimin e interesave të kredisë” njoftohen te gjithë qytetarët e interesuar te paraqesin aplikimet e tyre (faza e parë) për ” Programin Social te Strehimit” për “Subvencionimin e interesave të kredisë” pranë: **Njësi Administrative – Zyra me nje ndalesë( Z1N) , Zyra e protokollit**, pranon formularët e aplikimit sipas afateve të përcaktuara në thirrje nga data 16/06//2022 deri në datën 18/07/2022.

Programi Social i Strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë” synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.

Kriteret bazë për paraseleksionimin e kërkesës së paraqitur nga individet/familjet e interesuara për të përfituar nga programi social i strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë”, do të jenë:

- Individë të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mbushur moshën 18 vjeç;
- Familjet të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kanë në pronësi një banesë;
- Familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normën e strehimit;
- Familjet që zotërojnë te ardhura brenda kufijve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

Të ardhurat minimum dhe maksimum të përfituesve potencial

Struktura e familjes	Struktura e apartamentit	Kufiri maksimal i kredisë familje	Shpenzimet INSTAT referuar shkresës së MF nr 21113/2 prot, datë 10.12.2021	Niveli Maksimal i të ardhurave sipas shkronjës a të pikës 45 ,neni 2 ligj 22/2018	Niveli minimal i të ardhurave
1-3	Garsonier	1625000	12000-30592	50000	32000
2-4	1+1	1950000	25000-64783	Mbi 60000	38000
4-6	2+1	2600000	36000-92972	Mbi 80000	42000
Mbi 5	3+1	3200000	40000-93712	Mbi 90000	45000